

VENDIM
Nr. 506, datë 1.8.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 561, DATË 16.8.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT SIPAS GRADAVE PËR PUNONJËSIT, OFICERË DHE
NËNOFICERË, TË GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 561, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, lidhja nr. 1 “Niveli i pagës për gradë, sipas roleve për punonjësit e Gardës së Republikës”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për rritjen e pagave për vitin 2012.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2012.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha